

Të nderuar shtetas!

Kabineti i Këshillit të Ministrave.org është gjithmonë në dispozicionin tuaj, duke ju krijuar hapësirën e nevojshme për të shprehur mendimet, spiunimet, sugjerimet dhe sidomos lavdërimet tuaja të sinqerta ndaj punës së qeverisë të cilat na ndihmojnë të perfeksionojmë justifikimet. Gjithashtu, ne mirëpresim edhe kritikën tuaj më të fortë ndaj opozitës.

Të gjitha këto, ju mund të na shkruani duke klikuar tek zarfi blu [LEVDATA](#).

Megjithatë duke respektuar principin e fjalës së lirë, ju mund edhe të guxoni marrëzisht të na kritikoni duke na shkruar duke klikuar tek zarfi i kuq [ANKESA](#). Të jeni të sigurt se pasi ta plotësoni, ne do të bëjmë ç'është e mundur, t'ju gjejmë për t'ju "falenderuar" ngrohtësisht dhe personalisht.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

Z.Gojëpak LLAPASHUMI

Zëdhënës i Këshillit të Ministrave.org
Drejtori i Sektorit mbi Deklaratat e Dorëheqjeve

ANKESA



LAVDERIME

